

## Konferenca TeachBeyond Shqipëri

Me gëzim presim të jemi së bashku në Konferencën e 6-të vjetore të mësuesëve me temë:

### *Edukimi që ndërton mençurinë*

## Biografia e Prezantuesit - Phil Bassett



**Dr. Phil Bassett** ka një doktoraturë (Ph.D.) në Kurrikulë dhe Mesimdhënie nga Andrews University në Michigan dhe një diplomë master në Administrim të Shkollës së Krishterë nga Grace Seminary në Indiana. Ai punoi 11 vjet si mësues dhe administrator në shkolla fillore publike dhe private, para se të përfundonte studimet e tij doktorale në vitin 1991. Pas përfundimit të doktoraturës, Phil shërbeu për 13 vjet si profesor i edukimit në Cedarville University në Ohio.

Më pas u zhvendos në Pekin, Kinë, ku kaloi 16 vjet me International Schools of China, duke ofruar trajnime për mësuesit dhe kurse edukimi për shkolla ndërkombëtare dhe kineze. Gjatë karrierës së tij, ai ka mësuar dhe ka prezantuar workshope në dhjetë vende. Phil u kthye në Shtetet e Bashkuara në vitin 2020 për të marrë detyrën e Drejtorit të Mobilizimit të organizatës së tij. Që nga dalja në pension në vitin 2024, ai ka vazhduar të shërbejë globalisht duke ofruar konsulencë për iniciativat e trajnimit të mësuesve me TeachBeyond Albania dhe TeachBeyond Argentina. Phil dhe bashkëshortja e tij, Sue, janë të martuar që nga viti 1973 dhe kanë shtatë fëmijë dhe katërmëdhjetë nipër e mbesa. Djali i tyre më i vogël dhe bashkëshortja e tij kanë shërbyer në Tianjin International School në Kinë që nga viti 2014. Kjo është vizita e tretë e Phil në Shqipëri për të shërbyer me TeachBeyond Albania.

## Workshop 1

### **1 Thesalonikasve: Urtësia Biblike për Mësuesit Fokusi:**

Urtësi për mësuesit nga Apostulli Pal - njëri nga mësuesit më të mëdhenj në histori.

#### **Përshkrimi:**

Pali nuk ishte vetëm një apostull themelor, por edhe një mësues i jashtëzakonshëm, dhe marrëdhënia e tij me besimtarët e Thesalonikut ofron një model të fuqishëm të shkëlqimit mësimor. Në këtë sesion, do të eksplorojmë se çfarë mund të mësojnë edukatorët e sotëm nga qasja mësimore e Palit, zemra e tij baritore dhe investimi i tij personal te nxënësit e vet. Duke shqyrtuar pasazhe kyçe nga 1 Thesalonikasve, pjesëmarrësit do të marrin njohuri mbi komunikimin efektiv, inkurajimin, mentorimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve të thella dhe transformuese të të nxënësve. Ju ftojme të zbuloni se si shembulli i Palit ofron urtësi të përjetshme për mësuesit e sotëm.

## Workshop 2

**1: Të kuptuarit e Inteligjencës Artificiale: Çfarë është dhe pse ka kaq shumë debat?**

**2: Çështje Praktike të AI: Të kesh një Teologji dhe Filozofi të Inteligjencës Artificiale të ndihmon.**

**3: Çështje Praktike të AI: Kufizime dhe Udhëzime.**

### Fokusi:

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale në Arsim

### Përshkrimi:

#### AI 1

Në këtë sesion do të përkufizojmë AI në terma të thjeshtë (duke përdorur ChatGPT) dhe do të shqyrtojmë disa nga çështjet kryesore të lidhura me AI. Do të analizojmë gjithashtu disa nga gjetjet e raportit të fundit të Brookings mbi AI në Arsim, duke e vendosur AI-në në një kontekst më të gjerë historik.

#### AI 2

Në këtë sesion do të përdorim një seri artikujsh nga Qendra për Avancimin e Arsimit të Krishterë për të shqyrtuar çështje teologjike dhe filozofike të lidhura me AI.

#### AI 3

Në këtë sesion do të shqyrtojmë politika dhe udhëzime të sugjeruara nga literatura, si dhe disa udhëzime specifike nga politikat e LifePlus International School.

### Këto tre tema përmbledhin informacione nga:

1. Një seri artikujsh nga Qendra për Avancimin e Arsimit të Krishterë
2. Raporti i Brookings mbi AI në Arsim
3. Dy artikuj që i përgjigjen Raportit të Brookings
4. Politikat nga LifePlus International Schools
5. Materiale të ChatGPT për AI në Arsim

### Kjo informacion është i organizuar rreth temave të mëposhtme:

1. Të kuptuarit e AI dhe çështjeve të lidhura
2. Rëndësia e të menduarit rreth një filozofie dhe teologjie të AI dhe përdorimit të tij në klasë
3. Politika praktike, udhëzime dhe kufizime që lidhen me përdorimin e AI në shkolla.